



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), të dispozitave të nenit 30 të Ligjit nr. 03/L-175, për borxhet publike dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.05.2016, merr këtë

V E N D I M

Neni 1

I rekomandohet Ministrisë së Financave që në pajtim me nenin 18 të Ligjit 03/L-175, për borxhet publike, t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës miratimin e kërkesës së NPL "Trafiku Urban" SHA, për garanci shtetërore për marrjen e kredisë nga BERZH-i.

Neni 2

Komuna e Prishtinës zotohet që të marrë përsipër kthimin e borxhit, nëse NPL "Trafiku Urban" SHA dështon t'ia kthejë kredinë BERZH-it.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 040- 124276, më 23.05.2016



KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS
Halim Halimi, jur. i dipl.

[Handwritten signature]